



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
Sekretaria

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më ____ .10.2023

MBLEDHJA Nr. 51,
Datë 09.10.2023, ora 10:30
e Bordit të ERE-s

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të *Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funksionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020 dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të *Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 09.10.2023, ora 10:30**, do të zhvillohet mbledhja nr. 51 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi miratimin e procesverbal-ve të mbledhjeve të bordit të ERE-s më datë 25.09.2023 dhe datë 05.10.2023.
2. Mbi propozimin për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e strukturës së tarifave në ALPEX dhe miratimin e listës së tarifave
3. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” shpk, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike
4. Mbi rinovimin e licencës së shoqërisë “EZ-5 ENERGY” shpk, në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “ECO-ELB” sha për rinovimin e licencës në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike
6. Mbi një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.188, datë 16.11.2020, “Mbi licencimin e shoqërisë “IDI 2005” shpk në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC “KAMIÇAN”, me kapacitet të instaluar 1860 kW”, i ndryshuar

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

KRYETARI
Petrit AHMETI